



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:213996

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05575122

C.nr.1234/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit N.T.P "E.T", me seli në P, Rr. "V.F" nr..., me numër unik identifikues ... dhe numër biznesi ..., kundër të paditurit R.M – përfaqësues i autorizuar i kompanisë "C.P", me adresë në P, ... nr..., me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 10,815.22 €, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 15.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore, nën shenjen C.nr.1234/2017, sipas padisë së paditësit N.T.P "E.T", me seli në P, me numër unik identifikues ... dhe numër biznesi ..., kundër të paditurit R.M – përfaqësues i autorizuar i kompanisë "C.P", me adresë në P, për shkak të pushimit të ekzistuarit të palës paditëse.

II. Procedura e ndërprerë në këtë çështje do të vazhdohet kur pasardhësi juridik i palës paditëse ta marrë përsipër procedurën, apo kur t'i thërret gjykata ta bëjë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.P "E.T", me seli në P, me numër unik identifikues ... dhe numër biznesi ..., përmes përfaqësuesit të autorizuar, A.K, avokat me seli në P, pranë kësaj Gjykate, me dt.12.05.2017 ka parashtruar padi kundër të paditurit R.M – përfaqësues i autorizuar i kompanisë "C.P", me adresë në P, ... nr..., me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 10,815.22 €.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, përmes aktvendimit procedural C.nr.1234/17, të dt.05.03.2024, e ka kthyer në korrigjim – plotësim padinë e paditësit, duke e obliguar të njejtin që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi: 1) Ta plotësojë padinë, duke i bashkangjitur provat me të cilat mbështeten faktet e treguara në padi në numër të mjaftueshëm të kopjeve (ekzemplarëve) për gjykatën dhe palën kundërshtare dhe: 2) Ta plotësojë - korrigjojë padinë duke e përcaktuar saktë identitetin e palës së paditur. Me të njejtin aktvendim, pala

paditëse është obliguar që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, ta paguajë taksën gjyqësore për padi në shumën prej 100.00 € (njëqind euro), nën kërcënim të pasojave procedurale.

Aktvendimi i lartëcekur, në mbështetje të dispozitës nga neni 107 të LPK-së, palës paditëse i është dorëzuar përmes përfaqësuesit me autorizim (prokurë).

Përmes një parsahetrese, të protokolluar në Gjykatë me dt.14.03.2024, të emëruar “Revokim i autorizimit”, përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse e ka njoftuar Gjykatën se tani e tutje si Shoqëri e Avokatëve nuk do të vazhdojnë të jenë përfaqësues të paditësit për çështjen në fjalë, duke shtuar se mbeten në dispozicion për sqarime eventuale lidhur me këtë parashtresë.

Gjykata, bazuar në faktin se në cilësinë e palës paditëse na paraqitet një person juridik që njëkohësisht mban statusin e shoqërisë tregtare vendore, për verifikimin e të dhënave më të sakta iu referua regjistrin elektronik pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), me ç’rast nga hulumtimet e kryera rezultoi që subjekti me emrin tregtar N.T.P “E.T”, me numër unik identifikues ... dhe numër biznesi ..., figuron me statusin “shuar”.

Me rastin e vënies në dijeni lidhur me këtë rrethanë, Gjykata iu referua dispozitës së nenit 277 pika c) të LPK-së, e cila përcakton: “*Procesi gjyqësor ndërpritet: kur pala që është person juridik pushon së ekzistuari, respektivisht kur organi kompetent jep vendim të formës së prerë për ndalimin e punës tij*”. Bazuar në faktin se Gjykata disponon me dëshmi konkrete shkresore në drejtim të argumentimit të faktit se pala paditëse është shuar si biznes – respektivisht ka pushuar së ekzistuari, një rrethanë e tillë paraqet pengesë për procedim të mëtutjeshëm në këtë çështje kontestimore. Lidhur me prezumime procedurale të kësaj natyre, Gjykata në kuptim të dispozitës nga neni 76 të LPK-së duhet kujdesur gjatë gjithë procedurës sipas detyrës zyrtare. Në prezencën e rrethanave të konstatuara, e në kuptim të dispozitës së lartëcekur nga neni 277 pika c) të LPK-së, janë plotësuar prezumimet për ndërprerjen e procedurës në këtë çështje. Mbi këtë bazë, u vendos decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendosjen nga pika II e dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 280 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: “*Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.*”

Gjykata sjellë në vëmendje faktin se në kuptim të dispozitës nga neni 279 të LPK-së, si rezultat i ndërprerjes së kësaj procedure, rrjedhimisht ndërpriten edhe afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale dhe gjatë kësaj kohe nuk mund të ndërmerren kurrfarë veprimesh nga ana e Gjykatës, e po ashtu veprimet e kryera nga ndonjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk prodhojnë efekt juridik ndaj palës kundërshtare, deri në momentin e vazhimit eventual të procedurës.

Po ashtu, Gjykata sjellë në vëmendje faktin se në kuptim të dispozitës nga neni 95 par.1 të LPK-së, me shuarjen e paditësit si person juridik, rrjedhimisht është shuar edhe prokura (autorizimi) të cilën e ka dhënë për përfaqësim në këtë çështje kontestimore.

Mbi bazën e të lartëcekurave, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil -
C.nr.1234/2017, datë 15.04.2024

Gj y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.